



- [Të Reja](#) [Policia e Shtetit](#) [Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptar](#) [Shërbime](#) [Baza ligjore](#) [Vendndodhjet e policisë](#) [Video](#)
- [Programi i transparencës](#) [Kontakt](#) [Denonco Krimin Kibernetik](#) [Drejtoritë Vendore të Policisë](#) [Policia Kufitare](#) [Policia Rrugore](#)
- [Donacione](#) [Rubrika Policimi në Komunitet](#) [Përmbledhja Javore](#) [Për sinjalizimin](#)

Breaking News: DVP Vlorë – Vihen në pranga 2 shtetas, procedohen në gjendje të lirë 2 të tjerë
Raporti i ngjarjeve, 27 dhjetor 2023

Durrës – Sekuestrohen 600 fishekzjarrë dhe mallra të kontrabanduara. Procedohen penalisht 5 shtetas

Tiranë – Goditet një tjetër rast i mitëdhënies

Tiranë/Vihen në pranga 6 shtetas, për vepra të ndryshme penale



27/12/2023

Durrës – Sekuestrohen 600 Fishekzjarrë Dhe Mallra Të Kontrabanduara. Procedohen Penalisht 5 Shtetas

Durrës/Shërbimet e DVP Durrës dhe të DVKM Durrës, kontrole të shtuara në zbatim të masave të përcaktuara në planin operacional “Sundimi i ligjit”, për parandalimin e kontrabandimit të mallrave dhe të tregtimit të tyre në kundërshtim me ligjin.

-Goditen në Port Durrës, 2 raste të kontrabandës së mallrave të ndryshme (për disa prej tyre paguhet akcizë).

Sekuestrohen 600 fishekzjarrë, pajisje elektroshtëpiake, pije alkoolike dhe mallra të tjera. Procedohen penalisht 3 shtetas (2 drejtuesit e autobusit dhe drejtuesi i automjetit, ku u gjetën këto mallra).

-Goditen edhe 2 raste të shitjes së mallrave të ndryshme të kontrabanduara, pa pullë fiskale. Procedohen penalisht 2 shtetas, të cilët fshihnin të ardhurat e përfituara nga kjo veprimtari.

Në zbatim të masave të përcaktuara në planin operacional “Sundimi i ligjit”, për garantimin e rendit dhe sigurisë, parandalimin dhe goditjen e veprimtarive kriminale, shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës dhe të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Durrës, bazuar në informacionet e siguruar nga inteligjencia policore, kanë ushtruar kontrole në port Durrës dhe në subjekte të ndryshme tregtare, për të evidencuar raste të kontrabandimit të mallrave dhe të tregtimit të tyre në kundërshtim me ligjin.

Si rezultat i kontroleve me metoda bashkëkohore, në bashkëpunim me autoritetet doganore, shërbimet e Policisë Kufitare në Port Durrës kanë goditur 2 raste të kontrabandës së mallrave, për të cilat janë proceduar penalisht shtetasit:

B. C., 24 vjeç, banues në Kurbin, pasi gjatë kontrollit në automjetin tip “Benz” që drejtonte, shërbimet e Policisë gjetën 6 kuti me nga 100 fishekzjarrë secila, të padeklaruara;

O. A., 57 vjeç dhe Xh. H., 32 vjeç, të dy banues në Durrës, pasi gjatë kontrollit në autobusin e tyre, shërbimet e Policisë kanë gjetur rreth 200 shishe me pije të ndryshme alkoolike, pajisje të ndryshme elektroshtëpiake (mallra për të cilat paguhet akcizë) dhe mallra të tjera të padeklaruara.

Gjithashtu, si rezultat i kontroleve në terren, specialistët për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Financiare kanë goditur 2 raste të shitjes së mallrave të kontrabanduara, për të cilat janë proceduar penalisht shtetasit:

D. Ç., 39 vjeç, banues në Durrës, pasi gjatë kontrollit në dyqanin e tij, në lagjen nr.4, Durrës, shërbimet e Policisë gjetën pije të ndryshme alkoolike të kontrabanduara, pa pullë fiskale, të cilat ky shtetas i shiste duke fshehur të ardhurat;

A. V., 33 vjeç, banues në Durrës, pasi gjatë kontrollit në automjetin e tij, shërbimet e Policisë gjetën qindra paketa me cigare, të kontrabanduara, pa pullë fiskale, të cilat ky shtetas po i transportonte me qëllim shitjen.

Në përfundim të veprimeve procedurale, fishekzjarrët dhe mallrat e tjera u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale për secilin rast i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)